

VENDIM
Nr. 626, datë 26.10.2018

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË,
TË DISA SIPËRFAQEVE NGA TRUALLI FUNKSIONAL, I PRONËS NR. 180, ME
EMËRTIM “POLICIA USHTARAKE (REPARTI USHTARAK NR. 6620)” DHE I PRONËS
NR. 1265, ME EMËRTIM “OBJEKTE TË DHËNA PËR STREHIM”, ME
VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të sipërfaqes prej 506.14 (pesëqind e gjashtë pikë katërmëdhjetë) m² nga trualli funksional i pronës nr. 180, me emërtim “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)” dhe të sipërfaqes prej 143.2 (njëqind e dyzet e tre pikë dy) m², nga trualli funksional i pronës nr. 1265, me emërtim “Objekte të dhëna për strehim”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për nevoja urbanistike, për zbatimin e projektit të ndërtimit të rrugës “Danish Jukniu”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja prej 506.14 (pesëqind e gjashtë pikë katërmëdhjetë) m² nga trualli funksional i pronës nr. 180, me emërtim “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)” dhe sipërfaqja prej 143.2 (njëqind e dyzet e tre pikë dy) m² nga trualli funksional i pronës nr. 1265, me emërtim “Objekte të dhëna për strehim”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planvendosjeve dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqeve të pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronave, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronave nr. 180, me emërtim “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)” dhe nr. 1265, me emërtim “Objekte të dhëna për strehim”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike dhe për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

PRONA Nr.180 "Policia Ushtarake", Sauk Tirane.

MIRATO HET
KOMANDANTI POLICISE USHTARAKE
KOLONEL EKLAND DAUTI



PUNOI
Ing. Ermal MAÇI


PRETORI NGJYU
NIKOL ANE FERDA HYRAJ



IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 1605,3266.
Nr.Pasurise Vol. Fq.
Indeksi i Hartes
K-34-100-(27-B),K-34-100-(28-A).
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise Tirane
Q/F Sauk,Tirane.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes,Policia Ushtarake.

SHPJEGUESE

- Kufiri i pronës nr.180 sipas matjeve me GPS Dhjetor 2017
- Sip.e Pronës nr.180 matur ne dhjetor 2017 = 32147.54 m²
- Sip. qe ze rikonstrukcioni i rrugës "Danish Jukniu"= 506.14 m²
- Sip. që i mbetet pronës nr.180 =31 641.4 m²



Shënim:
Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së
Policisë Ushtarake nr.6040/1, datë 13.12.2017.
Bazuar në matjet e bera me Datë 13.12.2017 ne kufijtë faktik të
pronës ne prezencë te përfaqësuesit të Policisë Ushtarake

Tirane 14/12/2017

PLAN RILEVIMI

Prona nr.1265 "Objekte të dhëna për strehim Ushtarakëve", Sauk Tirane.

MIRAT TOHET
KOMANDANTI POLICISE USHTARAKE
KOLONEL EKLAN DAUTI

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 1605,3266.
Nr.Pasurise Vol. Fq
Indeksi i Hartes
K-34-100-(27-B),K-34-100-(28-A).
Shkalla 1: 2500

DREJTORI I IGJITJ
N/Kol. Ark.RERDI HYRAJ

Adresa e pasurise Tirane
Q/F Sauk,Tirane.


PUNOI
Ing.Ermet MAÇI

Pronari :

Ministria e Mbrojtjes,Policia Ushtarake.

SHPJEGJESE

- Kufiri i pronës nr.1265 sipas matjeve me GPS Dhjetor 2017
Sip.e Prones nr.1265 matur ne dhjetor 2017 = 2798.9 m²
Sip. qe ze rikonstruksimi i rrugës "Danish Jukniu"= 143.2 m²
Sip. që i mbetet pronës nr.1265 =2655.7 m²



Shënim:
Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së
Policisë Ushtarake nr.6040/1, datë 13.12.2017.
Bazuar në matjet e bera me Datë 13.12.2017 ne kufijtë faktik të
pronës ne prezente te perfaqesuesit të Policisë Ushtarake

Tirane 14/12/2017